



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Legjislatura VI**  
**Sesioni pranveror**

---

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike  
Mbledhja nr. 42  
Prishtinë, më 7.3.2019, në orën 9:45  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

**P r o c e s v e r b a l**

**Në mbledhje morën pjesë:** Time Kadrijaj, Danush Ademi, Dukagjin Gorani, Elmi Reçica, Evgjani Thaçi-Dragusha dhe Zafir Berisha.

**Munguan:** Vjosa Osmani-Sadriu, Glauk Konjufca, Fitore Pacolli, Doruntinë Maloku-Kastrati dhe Sergjan Mitroviç.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Artan Murati, Agnesa Haxhiu, KDI, Agonis Thaçi, D+ dhe media.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Time Kadrijaj, zëvendëskryetare e komisionit.

**Rendi i ditës:**

Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë.

**Time Kadrijaj**, theksoi se komisioni e ka proceduar për shqyrtim të komisionet e përhershme raportin me rekomandime, lidhur me Projektligjin nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë. Më tej, njoftoi se nga komisionet e përhershme, sipas kompetencës së tyre, na janë përcjellë rekomandimet, sipas të cilave, Projektligji nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend. Znj. Kadrijaj hodhi në votim raportin me rekomandime të komisionit për Projektligjin nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë.

Pas votimit të raportit me rekomandime për Projektligjin nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë, zëvendëskryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë:

### **Përfundim**

Miratohet, njëzëri, nga anëtarët e pranishëm në mbledhjen e komisionit, raporti me rekomandime për Projektligjin nr. 06/L-145 për detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e delegacionit shtetëror të Republikës së Kosovës në procesin e dialogut me Republikën e Serbisë dhe procedohet në procedurë të mëtejme në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 10:00.

**Zëvendëskryetarja e  
komisionit**

---

**Time Kadrijaj**

**E përgatiti:  
Stafi mbështetës i komisionit.**